



01/Nr. 9696/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 52, Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Thëmelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë neni 5, 6, Statuti i Komunës neni 37, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2021 merr:

V E N D I M

PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA TË KUVENDIT TË KOMUNËS

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për përbërjen e Komitetit për Politik dhe Financa si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.
2. Komitetit për Politik dhe Financa përbehet prej 5 anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:
 - 2.1. Florim Shkreta - Kryesues i Kuvendit të Komunës
 - 2.2. Ibadete Kalisi - PDK
 - 2.3. Sherif Berisha -LVV
 - 2.4. Refet Kalisi- LDK
 - 2.5. Nora Xhoni-AAK
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.12.2021





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9697 /2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 53, Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përherëshme dhe Komiteteve tjera në Komunë neni 8, Statuti i Komunës neni 38, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2021 merr:

V E N D I M
PËR PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për përbërjen e Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.
2. Komiteti për Komunitete përbehet prej 5 anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:
 - 2.1. Resul Suma -PDK
 - 2.2. Ajnure Thaçi-LVV
 - 2.3. Hanumshahe Dibrani-LDK
 - 2.4. Zaim Bela-AAK
 - 2.5. Mefail Suma-Shoqëria Civile
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.12.2021

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





01/Nr. 9699/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.1, 40, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 4. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2021 merr:

V E N D I M I N
PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për përbërjen e këshillit komunal për siguri në bashkësi në komunën e Hanit të Elezit.
2. Këshillit komunal për siguri në bashkësi do të ketë përbërje:
 - 2.1 . Kryetari i Komunës (Kryesues),
 - 2.2 . Komandanti i Stacionit të Policisë në komunën përkatëse;
 - 2.3 . Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës përkatëse;
 - 2.4 . Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të komunës përkatëse;
 - 2.5 . Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës;
 - 2.6 . Zyrtari për Barazi Gjinore;
 - 2.7 . Drejtori i Drejtorisë për Arsim;
 - 2.8 . Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës përkatëse;
 - 2.9 . Një përfaqësues i FSK-së;
 - 2.10. Një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike;
 - 2.11. Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
 - 2.12. Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale;
 - 2.13. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim;
 - 2.14. Një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.
3. Ekzekutimin e këtij vendimi e kryen kryetari i komunës.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.12.2021





01/ Nr.9698/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12.1, 82.2, Ligji Nr.05L-031- për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53, duke vepruar sipas Kërkesës së MPL-së Nr.020-893/11 të datës 02.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2021 merr:

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.8749/2021

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendi të Komunës 01/Nr.8749/2021 i datës 09.11.2021 për pajisjet teknologjike për stafin politik, ekzekutivin, legjislativin e komunës dhe punëtorët e arsimit.
2. Vendimi për shfuqizimin e vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi bëhet pas kërkesës së MPL-së të datës 02.12.2021 respektivisht konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Linjës - Ministria e Financave, Punës dhe transfereve sepse i njëjti bie ndesh me dispozitat e Rregullores MF Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30. 12. 2021

